Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 04.04.2022*	*Data e dorëzimit të raportit 13.04.2022*	Nr. i lëndës: *73/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.02.2022, OE **"Isars"Shpk** – Prishtinë,ka parashtruar ankesë me nr: 73/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **"Kompania Prishtina" Shpk -** Prishtinë,lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Ndërtimi i objektit Gjykata Themelore e Novobërdës –faza II",me nr.të prokurimit: 214-21-7130-5-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"MPB".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike,**Punë**,vlera e parashikuar e kontratës: **550,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 56.3 asnje OE nuk eliminohet per kerkesa qe nuk eshte cekur ne NJK dhe DT.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te RrUOPP-se

Nenin 26 Kriteret e perzgjedhjes,

Nenin 28 Kriteret e dhenies se Kontrates,

Nenin 41 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i tendereve,

Gjithashtu AK ka vepruar ne kundershtim me Vendimet e OSHP-së dhe intepretimet e KRPP-se.

Te pa kenaqur me vendimin e AK-së te dates 16.03.2022 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i objektit Gjykata Themelore e Novobërdës-faza II** me nr te prokurimit: **214-21-7130-5-1-1dhe** Nr i brendshëm: **214 21 080 511** ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se AK- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** :

1. ne menyrë të kundërligjeshme ka rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjeshem qe nuk i ka plotesuar kereksat e AK te vendosura ne njoftimin per kontrate-NJK dhe ne dosje te tenderit –DT por qe ka ofertuar me oferten me çmim më të shtrejt se oferta e jonë.
2. ne menyre te kunderligjeshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kereksat e AK te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Sqarojmë ne menyre te detajuar pikat:

A. grupi i OE-ve te shperblyer me kontrate eshte i pa pergjegjeshem:

Autoriteti Kontraktues – AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME per here te dytë me plot vetedije dhe me qellim kane shperblyer me kontrate nje OE te pa pergjegjeashem njejte si ne heren e pare e kane shperblyer me kontrate nje operator i cili kishte dokumente te falsifikuara dhe nuk i kishte plotesuar kerkesat e AK-se por AK e kane shpalle te pergjegjeshem dhe e kane shperblyer me kontrate ku pas kerkeses tone per rishqyrtim AK eshte detyruar ta eliminoj ate OE dhe tani AK e ka perserit gabimin e njejte me plote qellim dhe me plote vetedije ku kane rekomanuar per kontrate nje OE me te shtrejte se ne dhe qe eshte i pa pergjegjeshem. Me keto veprime zyrtaret e AK po i tejkalojne kompetencat e veta te cilat ja jep LPP. AK ne menyrë të kundërligjeshme ka rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjeshem qe nuk i ka plotesuar kereksat e AK te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit ku kunderligjeshem e shperblen me kontrate Grupin e Operatoreve Ekonomik: **Kompania Prishtina shpk**, Selman Riza **ne vlere prej 474,222.00€.**, me te shtrejte mbi **34,907 € (tridhjete e kater mijë e nenteqind e shtate euro)** shum e cila po tentohet ti demtohet buxhetit te Kosoves.

Pas qasjes ne dokumente zyrtare kemi hasur se Grupi i Operatoreve qe AK ka shperblyer me kontrate nuk i ka plotesuar keresat e AK-se te vendosura ne dosje te ternderit dhe ne njoftimi per kontrate si ne vijim:

1. **Menaxheri i Projektit pa reference sipas kerkeses se dosjes se tenderit.**

AK ne NJK dhe DT ka vendosur kerkesen si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

5. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë.

Tek *Dëshmia e kërkuar dokumentare ka kerkuar që :*

5. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal), Referencat për punët e mëparshme nën mbikëqyrje në lëmin e ndërtimit të lartë të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilët lëshohet referenca.

Menaxheri i projektit **Bashkim Kosumi**, Sipas kërkesës, kërkohet **Referencat për punët e mëparshme nën mbikëqyrje në lëmin e ndërtimit të lartë të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilët lëshohet referenca**, Nuk posedon nje reference të tillë , është prezentuar një referencë e përgjithëshme që i mungon vlera e projketve te realizuara dhe vendi i ekzekutimit të projektit. Gjithashtu edhe CV e **Menaxherit** të projektit **Bashkim Kosumi**, nuk i permban te dhenat e kerkeara ne NJK dhe DT rrjedhimisht konform RrUOPP-së neni 39.8 Ky OE eshte i pa pergjegjeshem pasi qe referenca dhe CV e dorezuar nuk eshte konform kerkesave te AK-së dhe AK eshte dashur menjeher ta eliminoj kete OE. Me poshte e keni nenin e RrUOPP-se:

39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. **Nënshkrimi digjital nuk është i obligueshem deri ne njoftim zyrtar nga KRPP.**

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Shembull konkret CV e **Hysen Merovci** Inxhinier i diplomomuar i Ndërtimtarisë i permban te dhenat e kerkuara dhe i ploteson kerekesat e NJK dhe DT te vendosura nga AK.

2. Inxhinieri i Dipl i ndertimtarise nuk eshte i punesuar ne Kompanine Prishtina.

AK ne NJK dhe DT ka vendosur kerkesen si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit

Tek *Dëshmia e kërkuar dokumentare ka kaerkuar që*

Diploma e noterizuar, CV e nënshkruar nga inxhinieri (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës (kopje) valide për këtë projekt me punëdhënësin, minimumi një referencë (kopje) të lëshuar nga punëdhënësi, që duhet të përmbaj titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilin lëshohet referenca.

Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarisë Hysen Merovci, Në listat e pagave nga ATK-ja të dorezuara nga kompania shihet që inxhinierit në fjalë nuk i janë paguar kontributet për vitet 2018,2019,2020,2021 edhe pse në kontratën e rregullt te ofruar figuron që është i punësuar i rregullt nga viti 2005 si inxhinier i Ndërtimtarisë në kompani.

Nga kjo mund të vim në dyshim se inxhinieri mund të mos jetë të në dijeni se dok i shfrytëzohen nga kompania në fjalë.

3. Te gjitha kontratat e stafit menaxhues te falsifikuara.

Operatori i Shpallur fitues i ketij projekti Kompania Prishtina ka prezantuar kontrata te falsifikuara me ane te te cilave eshte munduar te mashtroj AK-ne se stafi menaxhues kane qene te punesuar nga viti 2005 ne kete kompani dhe kinese keto kontrata jane perpiluar dhe nenshkruar nga palet me vitin 2005 ndersa ne preambulen e kontrates Kompania Prishtina eshte thirrur ne Ligjin e Punes te vitit 2010 per kete veprim te ketij OE, AK eshte e obliguar qe konform nenit 99 te LPP-se ta dergoj ne OSHP dhe Ky OE te futet ne Liste te Zezë.

Me poshte e keni kontraten e Ekonomistit te Diplomuar Rizah Azemi :

Ne menyre te njejte jane edhe kontratat e Punetoreve teknik si psh. Kontrata e Blerim Gashi e nenshkruar me 2009 ndersa preambula e vitit 2010. Kontrata e Jakup Berisha eshte e nenshkruar me 01.05.2006 ndersa ne preambule thuhet se eshte perpiluar sipas Ligjit te Punes te dates 01.12.2008. Ndersa Kontrata e Sami Ejupi thuhet se punesimi fillon me 01/03/2012 ndersa eshte e nenshkruar me 01.03.2021. Gjithashtu edhe Kontrata e Skender Berisha, Gjithashtu edhe nenshkrimi i punedhenesit dallon pothuajse te secila kontrate, ndersa dyshojme se edhe te punesuarit i kane nenshkruar me doren e tyre sepse secila kontrate e ka shkronjen e pare te emrit pastaj vazhdon me mbiemer gje qe nuk eshte e mundur qe te gjithe punetoret ta kene neshkrimin ne kete format.

Siç po shihet me larte AK ka vepruar ne kundershtim me vetveten pasi qe ne NJK dhe DT

Ne faqen 16 te dosjes se tenderit ka parapare qe **Kriteret e Dhënies 30.1** Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**]; ☒

Pra AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 60 te LPP-se pasi qe ka rekomanduar OE te pa pergjegjeshem kurse eshte dashur qe te na rekomandoj neve per kontrate pasi qe kemi dorezuar tender te pergjegjeshem me çmim me te ulët.

Ne si Operator Ekonomik jemi te demtuar nga ky vendim i AK i cili eshte i kunderligjeshem dhe nje tentim per ta demtuar Buxhetin e Kosoves ne menyre te kunderligjeshme pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT kuse AK ka shpallur fitues Operatorin me çmim me te shtrejt i cili nuk i ka plotesuar kerkesat e Ak-se te vendosura ne NJK dhe DT si dhe ka ofertuar me çmim me te shtrejtë.

Neve nuk do te kishim hyre dhe nuk do te na kishte interesuar se a i ploteson apo jo OE i rekomanduar kekresat e AK-se, pra pa marre parasysh qe OE ka ofertuar me dokumentet e me siperme, sepse per kete procedure nuk eshte relevante se a eshte apo nuk eshte i pergjegjeshem njo operator ekonomik i cili ka ofertuar me çmim me te shtrejte se neve, por neve na brengos fakti se pse neve elimonohemi per kerkesa te cilat nuk jane te NJK dhe DT, kurse OE-te tjere kane ofertuar me çmime me te shtrejta dhe nuk i plotesojne krekesat e AK-se e ne fund shperblehen me kontrate.

B. Arsyeja e eliminimit tone eshte e kunderligjshme:

Siç e kemi cekur edhe ne kerkesen e pare per rishqyrtim por edhe ne te dyten, AK na ka eliminuar pa te drejte ne kete aktivitet te prokurimit dhe ne kundershtim me dipsozitat e LPP-se pasi qe per nje kerkese qe nuk e ka vendosuar as ne NJK e as ne DT, pra AK ka vendosur si me poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitektures min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektroteknikes - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i makinerisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Pra siç po shifet i ka kerkuar 5 ing te ndryshem ndersa tek pika e njejte ka kerkuar:

5. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë.

Pra AK askund kuk e ka cekur se Menaxheri i projketit duhet te jete inxhinier tjeter nga keta te 5 te kerkuar si ne NJK dhe DT. Pra nuk ka qene kerkese e AK-se qe te jene 6 inxhinier por ka qene kerese te jene 5 e kga keta te pestit njeri te jet meaxher i projektit te drejtiomit konstruktiv ose i arkitektures, pra duke pasur parasysh që nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, atehere i bejme me dije AK-se se asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 56 paragrafi 3 ku shkruan *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

Neve kemi prezantuar **Inxhinierin e Diplomuar të Arkitekturës Shefvqet Mullafazliu**. Dokumentacioni i Inxhinierit të diplomuar të Arkitekturës mund të gjenden në folderin e personelit me numer rendor 1 i titulluar ING Arkitekturës SHM, branda fajllit të inxhinierit mund të gjendet Cv e nenshkruar nga vet inxhinierit, diploma e noterizuar nga vet inxhinieri, Çertifikata e provimit profesional,referenca për punë të kryera nga Danish Red Cross, kontarta e punës nga ISARS shpk dhe referncat për punët e kryera.

Inxhinieri ka përvoj pune shumë vjeçare andaj si i tille i plotëson të gjitha kriteteret e caktuara nga AK NJK dhe DT.

Neve kemi hulutmuar edhe vendimet e paneleve shqyrtuese te OSHP-se ku ka patur raste edhe me te renda por kur kerkesa nuk ka qene qarte e shkruar nga AK se ne oferte duhet te kete 6 inxhinier por AK nuk e ka specifikuar saktesisht erkesen e vet atehere paneli shqyrtues ka vendos ne favor te OE-ve qe jane ankuar lidhur me kete pike ku sa per ilustrim kemi vendiomet e OSHP-së : PSH 320/20 pastaj PSH 476-489/20 dhe shume vendime te tjera ku Ekspeti shqyrtues qe do ta shqyrtoj kete ankese e din me mire apo edhe vet paneli shqyrtues.

Krejt ne fund

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qellimi i ketij neni eshte qe Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ku haptas po na diskrimonon neve si OE pasi qe eshte hera e dyte qe AK po shpall fitues operator te pa pergjegjeshem dhe me dokumente te falsifikuara, sikur mos te kishim bere kerkese per rishqyrtim heren e pare Ak e kish nenshkruar kontraten me nje operator te pa pergjegjeshem dhe qe eshte konstatuar me prova qe ka ofertuar me dokumente te falsifikuara njejte siç po e faktojme edhe tani per kete OE.

AK ne vend qe te na faleminderoj dhe te na shperbleje me kontrate pasi qe nuk po e lejme te gaboj ku ne te ardhmen do te kete telashe edhe me zyren e Auditorit pasi qe keto shkelje pateter qe auditori do ti has dhe keto shkelje auditori menjeher do ti dergon ne hetuesi, ku zyrtaret e Ak-se do te kene probleme me ligjin, neve diskriminohemi dhe sikur me inat nga zyrtaret e AK-se eliminohemi per kerkesa qe nuk jane te parapara nga AK pra neve kemi ofertuar me tender te pergjegjeshem dhe me çmim me te lire.

E njoftojme Panelin Shqyrtues se Autoriteti kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk

është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ku AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 60 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit ka vepruar edhe ne kundershtim me nenin 65 te LPP-së ku ka rekpmanduar per kontrate OE i cili eshte i arrestuar dhe ndiqet penalisht per falsifikime ne prokurim.

Kerkojme nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se qe te mos na diskrimonoj dhe te na aprovoj te gjitha pretendimet tona ankimore sepse shihet qarte se AK ka vepruar kunderligjeshem dhe po tenton qe ta demtoj Buxhetin e Shtetit, *Neve edhe pse I kemi shkruar AK-se ne kerkesen per rishqyrtim se nuk do te ndalemi qe ti kerkojme te drejtat tona te cilat na takojne me ligj, nuk po kerkojme diçka çka nuk na takon, jemi operator i pergjegjeshem, kemi punuar ndershem dhe kemi ndermend te punojme ndershem deri ne fund. Ne çdo pune qe e kemi punuar kemi Lavdata nga te gjitha Autoritetet Kontraktuese, nuk ka ndodhe qe ti lejm punet ne gjysme dhe nuk e kemi asnje procedure ne gjykate ku e kemi lene ne gjysme ndonje pune tek ndonje Autoritet Kontraktues, tani ne kohen e fundit kemi punuar edhe pa asnje fitim e ne ndonje Autoritet Kontraktues edhe me humbje pasi qe jane rritur çmimet por nuk e kemi nderprere asnje kontrate nga ana jone.*

Nuk kemi deshire qe te inicojme procedura per keqperdorim te detyres zuyrtare deri me sot asnjeher nje gje te tille nuk e kemi bere por sipas veprimeve tuaja po na detyroni.

AK nuk na ka marre parasysh keto njoftime tona dhe ka vazhduar ne te veten.

Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, shihet qarte se Operatori i shpallur fitues nuk ka parashtruar kekese per rishqyrtim ne heren e pare (as operatoret tjere) qe do te thote se ky OE dhe OE-te tjere kane hequr dore nga kjo procedure e prokurimit dhe rezulton se te gjithe OE-te tjere perveç neve, janë palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 108/A paragrafi 1-14 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë keta OE nuk ka munden të dëshmojë se nese ne te ardhmen nuk shpallen fitues ju shkaktohet dëme dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, te njëjtit operator në asnjë variant nuk munden të shpallet fitues te këtij tenderi. Pra kerkojme nga Paneli shqyrtyes qe ta shqyrtoj kete pike sepse eshte mjaft me rendesi pasi qe shume vendime te OSHP-se jane xjerre konform ketij neni ne te kaluaren.

Besojme se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne kete aktivitet te Prokurimit andaj, Kerkojm nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së qe ta detyroj Autoritetin kontratktues qe ti rrespektoj ne perpikeri dispozitat e ligjit te prokurimit publik gjithashtu ti rrespektoj kerkesat e veta te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit dhe te nxjerr;

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik **ISARS shpk** Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i objektit Gjykata Themelore e Novobërdës-faza II**. te inicuar nga AK- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

II. ANULOHET njoftimi per dhenie te kontrates Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i objektit Gjykata Themelore e Novobërdës-faza II**. te inicuar nga AK- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** dhe lenda kthehet ne Rivleresim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa: *5. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë.*
Dëshmia: *5. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal), Referencat për punët e mëparshme nën mbikëqyrje në lëmin e ndërtimit të lartë të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilët lëshohet referenca.*
Kërkesa : *Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitektures min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.*
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektroteknikes - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i makinerisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Dëshmia: *Diploma e noterizuar, CV e nënshkruar nga inxhinieri (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës (kopje) valide për këtë projekt me punëdhënësin, minimumi një referencë (kopje) të lëshuar nga punëdhënësi, që duhet të përmbaj titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilin lëshohet referenca.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit,komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni për rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre të datës 07.03.2022, nga dhjetë (10) oferta të dorëzuara, gjashtë (6) oferta i ka vlerësuar si të përgjegjshme,duke rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Kompania Prishtina"– Prishtinë me çmim prej 474,222.00 €.

Sa i përket ofertës së OE ankues "Isars"Shpk–Prishtinë,nga komisioni i rivlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin :
Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vërejtur se në dosjen e tenderit përveç tjerave është kërkuar edhe që operatori ekonomik të ketë (1) Një Inxhinier të diplomuar ose Master të Arkitekturës,ndërsa OE "Isars" Shpk nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftuar siç është kërkuar në dosjen e tenderit për arsye se Arkitektin/at e prezentuar nga kompnia (Butrint Golaj dhe Remzi Hoxha) janë Bachelor të Arkitektures dhe si të tilla nuk e plotësojne kërkesën e parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë,andaj kjo kompani nuk kalon në vlerësim të mëtutjeshëm.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ISARS"SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Isars"Shpk, se AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eleminuar oferten e tyre edhe pse ofertë më e lirë me arsyetimin se inxhinieri i Arkitekturës nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, që sipas OE ankues inxhinieri i Arkitekturës i caktuar edhe si menaxher i projektit i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 59 dhe neneve tjera të LPP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknk dhe profesional është kërkuar:

5.Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitektures min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv- min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektroteknikes - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i makinerisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues (B58) të datës 07.03.2022 oferta e OE ankues "Isars"Shpk është eleminuar me arsyetimin:
Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vërejtur se në dosjen e tenderit përveç tjerave është kërkuar edhe që operatori ekonomik të ketë (1) Një Inxhinier të diplomuar ose Master të Arkitekturës,ndërsa OE "Isars" Shpk nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftuar siç është kërkuar në dosjen e tenderit për arsye se Arkitektin/at e prezentuar nga kompania (Butrint Golaj dhe Remzi Hoxha) janë Bachelor të Arkitektures dhe si të tilla nuk e plotësojne kërkesën e parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë,andaj kjo kompani nuk kalon në vlerësim të mëtutjeshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “Isars”Shpk për menaxher të projektit ka caktuar z.Shevqet Mullafazliu –inxhinier i diplomuar i arkitekturës i cili përmbush kërkesat e dosjes së tenderit për menaxher të projektit,ndërsa ka dorëzuar dokumentacionin edhe për dy inxhinier të arkitekturës të cilët nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit (Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitektures min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit),konkretisht për Butrint Golaj i dip. në bachelor për arkitekturë dhe Remzi Hoxha që është në vijim të studimeve të cilët nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit.
Pretendimi ankimor i OE ankues se në dosje janë kërkuar pesë (5) inxhinier e jo gjashtë (6) duke pretenduar që menaxheri i projektit duhet të pranohet për dy kërkesat e para të listuara më lartë për ekspertin shqyrtues është i paqëndrueshëm sepse të dy kërkesat e para janë më specifika të ndryshme dhe jane dy kërkesa të ndryshme,konkretisht për menaxherin e projektit është kërkuar të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë,ndërsa për inxhinierin e Diplomuar ose Master i Arkitektures është kërkuar min.3 vjet përvojë pune pas diplomimit.
OE ankues “Isars”Shpk nëse ka pasur paqartësi rreth kërkesave të dosjes së tenderit ka mundur të kërkoj sqarime në fazën e parë para dorëzimit të tenderit.

Sa i përket vendimeve të Panelit Shqyrtues,PSH nr.320/20 dhe PSH.nr.476-489/20 në të cilat është thirrur OE ankues si analogji e rasteve sipas të cilave Paneli i OSHP-së për raste të njejta ka vendosur në favor të OE, eksperti shqyrtues nuk pajtohet me këtë pretendim të OE ankues sepse vendimi i OSHP-së ka të bëjë me profilet e punëtorëve që nuk ka qenë e sqaruar mirë në dosje të tenderit por nuk ndërlidhet me rastin konkret, citoj një pjesë të vendimit:

Ndërsa sa i përket kërkesës: “Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës”, mendoj se kjo kërkesë nuk është e sqaruar se pesë (5) të punësuarit të cilëve profile duhet të jenë, andaj si i tillë ky arsyetim i AK-së për eliminim të OE ankues është i pabazuar. Duke pasur parasysh këtë

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë (“Kompania Prishtina”Shpk), nuk është i përgjegjshëm sepse menaxheri i prezentuar nga kjo kompani nuk ka ofruar referencat sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe CV e menaxherit të projektit nuk përmban të dhënat e kërkuara,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë e dëshmuar me diplomën e noterizuar, CV e nënshkruar nga inxhinieri (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës (kopje) valide për këtë projekt me punëdhënësin, minimumi një referencë (kopje) të lëshuar nga punëdhënësi, që duhet të përmbaj titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilin lëshohet

referenca..

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vendimin për caktimin e z.Bashkim Kosumi-inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë.
Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një referencë për z.Bashkim Kosumin ku janë përmbledhur të gjitha angazhimet në projekte të ndryshme duke përfshirë edhe projektet e ndërtimit të lartë.Pretendimi i OE ankues se menaxherit i mungon vlera e projekteve dhe vendi e ekzekutimit të projketeve në referencën e prezentuar për ekspertin shyrtues referenca e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë për menaxherin përmban të dhënat e domosdoshme sepse në dosje të tenderit nuk është kërkuar ndonjë shumë e caktuar për referenca që të mund të kontestohej referenca e dorëzuar.Meqense z. Bashkim Kosumi punon në "Kompanina Prishtina "Shpk që nga viti 2012 sipas kontratës së prezentuar, një lidhshmëri e referencave të paraqitura mund të bëhët edhe me Listën e kontratave të realizuara nga OE "Kompanina Prishtina "Shpk.Sa i përket CV- së menaxherit në dosje të tenderit është kërkuar vetëm CV e nënshkruar nga menaxheri(orgjinal) dhe kjo CV është dorëzuar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe për ekspertin shqyrtues ky pretendim i OE ankues është i paqartë sepse nuk ka ndonjë formë unike të CV-së dhe secili OE apo person e prezenton CV ne formatin e tij.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë për inxhinierin e ndërtimtarisë z.Hysen Merovci ka dorëzuar një kontratë që ka mospërputhje të datave të preambulës dhe të nënshkrimit të kontratës dhe i cili nuk figuron në listat e ATK-së për vitet 2018,2019,2020 dhe 2021 të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe sipas OE ankues z.Hysen Merovci mund të mos jetë në dijeni së dokumentet e tij shfrytëzohen nga OE "Kompania Prishtina"Shpk,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë për inxhinierin e ndërtimtarisë z.Hysen Merovci ka dorëzuar këtë kontratë të prezentuar më poshtë si të shkurtuar.

Kompania "Prishtina"Shpk

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2,pika 2.1 dhe 2.2,të nenit 11 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 I shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,me dt01.12.2010,Punëdhënësi dhe I Punësuari ,si subjekte të marrëdhënies juridike të punës,lidhin:

KONTRATË PËR PUNËSIM

Neni 1

Me këte Kontratë Kompania"Prishtina"shpk,me NRB 70294046 dhe nr. Fiskal 600109723 ,Rruga"Selman Riza" nr.10 Prishtinë.
Te cilen e perfaqeson Rizah Azemi (më tekstin e mëtejeshëm punëdhënësi) lidhe kontratë pune me Hysen Merovci me ID 1000903[illegible]530, Inxh.e dipl.e Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv, nga Fushë Kosovë.

Neni 2

Vendi :
Prishtinë,data 26.06.2005

I punësuari

Punëdhënësi

Eksperti shqyrtues konsideron që në kontratën e prezentuar ka mospërputhje në mes të datës së preambulës (01.12.2010) dhe datës së nënshkrimit të kontratës (26.06.2005) që është shumë para datës së preambulës.AK konform nenit 59.2 të LPP-së ka mundur të kërkoj nga OE "Kompania Prishtina"Shpk sqarime për kontratën e dorëzuar në mënyrë që të vërtetohet autenciteti i kësaj kontrate,andaj konsideroj që pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se të gjitha kontratat e stafit menaxhues të OE të rekomanduar për kontratë janë të falsifikuara, eksperti shqyrtues sqaron se nuk është në kompetencë dhe përgjegjësi të ekspertit shqyrtues të verifikoj dokumentet e falsifikuara,por nëse OE ankues ka dyshime se këto kontrata janë të

falsifikuara atehërë duhet ti drejtohet institucioneve kompetente që trajtojne rastet e tilla.

Konsideroj që AK në përgjithësi ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit, për kontratën e inxhinierit të ndërtimtarisë të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë AK duhet të kërkoj sqarime shtesë me qëllim të sqarimit të mos ndërlidhshmërisë së datës së preambulës me datën e nënshkrimit të kontratës,andaj rekomandoj që të lënda të kthehet në rivlerësim.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si pjesërisht e bazuar**,të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - "MPB"
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - "ISARS"SHPK